



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 227/3 Prot.

Tiranë, më 30 /03/2016

VENDIM  
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 08, datë 30/3 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 227 Prot., datë 29.02.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Kulturës me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtarë”.

Ankuesi , në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 07.12.2015 i ka kërkuar Ministrisë së Kulturës një kopje të konceptit kuratorial dhe metodologjisë së fituesit të Pavijonit Shqiptar në Bienalen e Arkitekturës në Venecia 2016. Me shkresën nr.6083/1 Prot., datë 16.12.2015 Ministria e Kulturës i ka kthyer përgjigje duke e njoftuar të paraqitet pranë Ministrisë së Kulturës në ditë dhe orar të rënë paraprakisht dakort me përfaqësuesit e Autoritetit Publik, për t’u njohur nga afër me platformën në fjalë. Më datë 02.02.2016 platforma e fituesit i është vënë në dispozicion nga afër , por i është ndaluar dhënia e një kopje të materialit.

, në vijim ka bërë ankesë pranë zyrës së Komisionerit duke kërkuar që t’i vihet në dispozicion një kopje të konceptit kuratorial dhe metodologjisë së fituesit të Pavijonit Shqiptar në Bienalen e Arkitekturës në Venecia 2016.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhrin nr. 55 datë 10.03.2016, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Ministria e Kulturës.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e është depozituar pranë Ministrisë së Kulturës dhe është regjistruar me nr. 6083 Prot, datë 07.12.2015, si dhe me shkresën nr.6083/1 Prot, datë 16.12.2015 i është kthyer përgjigje kërkuarit.

Gjithashtu përfaqësuesit e Autoritetit Publik sqaruan se: *Informacioni i kërkuar nga është një dokument që nuk ka të bëjë me informacion për publikun. Është një produkt intelektual në formën e një platforme i hartuar nga individë të huaj, të cilët kanë marrë pjesë në një konkurs të zhvilluar nga Ministria e Kulturës në kuadër të përfaqësimit të Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës në Venecia në vitin 2016. Nga ana e autorëve nuk është lënë asnjë autorizim ku lejohet Ministria e Kulturës të riprodhojë apo shpërndajë këtë material duke*

patur parasysh që ai është dokument që përfshihet edhe në zbatimin e ligjit Nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", Po kështu, neni 17, pikë c) e ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon përjashtim nga zbatimi i ligjit për të dhënat që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit, si rasti konkret. Autorët e këtij projekti janë shprehur se ky projekt i tyre nuk mund të jetë publik deri në momentin e hapjes së Bienales më datë 26 maj.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit, vlerëson se Autoriteti publik/Ministria e Kulturës ka përmbushur detyrimin, në kuptim të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke i kthyer jo vetëm përgjigje me shkrim brenda afateve ligjore, por gjithashtu duke i krijuar mundësinë të njihet nga afër me informacionin e kërkuar.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e ndaj Ministrisë së Kulturës, Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit 49/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 227 Prot., datë 29.02.2016 të kundër Autoritetit Publik/ Ministrisë së Kulturës.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja në dijeni e këtij vendimi.
3. Ky vendim u dha sot në datë 30.03.2016.

